



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 451/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kryesuesit të vendotimit 1909/4E në shkollën fillore “Dardania” në Prishtinë, për shkak të përcjelljes së votuesit deri në kabinën e votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** ankesa si e pabazuara e subjektit politik Fryma e Re (FER).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik FER, me të cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në shkollën fillore “Dardania” në Prishtinë, në Qendrën e Votimit (QV) nr. 1909/04E, ka pas parregullsi gjatë procesit të ngase Gani Arifi në cilësinë e kryesuesit të vendotimit ngase i ka përcjellur votuesit deri në kabinën e votimit, siç theksohet në ankesë kjo është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 89 paragrafët 5 dhe 7.

Parashtuesi i ankesës nuk ika bashkangjitur asnjë provë ankesës.

Në raportin e Policisë të datës 13.12.2010, me nr. SPJ-AS-1/0266/10, theksohet se në gjatë gjithë kohës në këtë QV kanë qëndruar zyrtaret policor dhe nuk është vërejtur asnjë parregullsi. Po ashtu nuk është kërkuar asnjëherë nga kryesuesi i QV, që të ndërmerret ndonjë veprim nga policia.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga kryesuesi i vendotimit siç potencohet në ankesë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 451/2010 më datën 14.12.2010.

Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj

